MESAZH ME RASTIN E FILLIMIT TË VITIT TË RI HIXHRI 1443

VETËVRASJA SI NJË PLAGË E DHIMBSHME E SHOQËRISË SONË

VEPRA TË MIRA QË E MBROJNË NJERIUN NGA NDËSHKIMI I XHEHENEMIT

UDHA ISLAME

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Viti 19 - Nr. 8 (222), Gusht, 2021

www.myftinia-shkoder.org

MYFTINIASHKODER1990

"Hixhreti ka ndryshuar rrjedhat e historisë së njerëzimit"!

Falë hixhretit, bota mësoi të vlerësojë jetën, të respektojë lirinë e përzgjedhjes, të dënojë devijimin dhe prishjen e ekuilibrave të natyrës së pastër në të cilën na krijoi Zoti...

INFRASTRUKTURA RRUGORE PËR TË DËSHIRUAR, QEVERIA DHE PUSHTETARËT MË SHUMË VËMENDJE NDAJ SHKODRËS...

Kjo është një ftesë për kryeministrin e vendit tim, për ministrat e vendit tim, për deputetët e Shkodrës, për drejtuesit e ndryshëm të Shkodrës, që edhe pse jemi në vitin 2021, nuk kemi një rrugë normale për të shkuar drejt kryeqytetit apo për të ardhur dikush nga kryeqyteti në kryeqendrën e veriut. Kjo është e pafalshme, të dashurit e mi!

Njëkohësisht e nisa këtë mesazh, sepse dua në fakt të falënderoj policët e trafikut, që shumë prej tyre... **(f. 2)**

DR. MURHAF SAKKA: "MODELI I PROFETËVE, SHEMBULL FRYMËZUES I BASHKIMIT NË MESIN E NJERËZVE!"

Dr. Sakka gjatë ligjëratës së tij, pasi çmoi lart qytetin e Shkodrës për mikpritjen, bujarinë, për vlerat e besimit dhe harmonisë në mes njëri-tjetrit, dha disa këshilla dhe mesazhe të çmueshme për imamët, të cilët sipas tij gjatë thirrjes islame duhet të kenë parasysh disa detyra; të jenë shembull besimi, adhurimi dhe morali në shoqëri, model i profetëve, shembuj frymëzues të bashkimit në mes njerëzve, ruajtës të traditave dhe zakoneve të mira që janë vlerë e shtuar e besimit si dhe të thërrasin njerëzit në besim të vërtetë... **(f. 16)**

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

INFRASTRUKTURA RRUGORE PËR TË DËSHIRUAR, QEVERIA DHE PUSHTETARËT MË SHUMË VËMENDJE NDAJ SHKODRËS...

Të dashurit e mi!

Përpara se të zbres nga minberi kam një mesazh, një falënderim, një lutje, por kam edhe një tërheqje vëmendjeje.

M'u kujtua gjatë këtyre ditëve në disa prej udhëtimeve jo të largëta, më e pakta Tiranë-Shkodër vajtje-ardhje, që gjithsejt të shkon rreth 7 orë, m'u kujtua Hz. Omeri (r.a), i cili një ditë prej ditëve të pushtetit të tij të lavdishëm, u pa duke qarë dhe e pyetën se përse po qante! – "Më shkon ndër mend se mos ndoshta nuk e kemi shtruar rrugën e dhive diku atje larg në Irak dhe ndonjëra prej tyre duke ecur, mund ti thyhet këmba. Dhe do më pyesë Allahu në Ditën e Gjykimit për hakun e dhive"!

Kjo është një ftesë për kryeministrin e vendit tim, për ministrat e vendit tim, për deputetët e Shkodrës, për drejtuesit e ndryshëm të saj, që edhe pse jemi në vitin 2021, nuk kemi një rrugë normale për të shkuar drejt kryeqytetit apo për të ardhur dikush nga kryeqyteti në kryeqendrën e veriut. Kjo është e pafalshme, të dashurit e mi!

Njëkohësisht e nisa këtë mesazh, sepse dua në fakt të falënderoj policët e trafikut, që shumë prej tyre i kemi shokë e vëllezër, që rrinë në këtë vapë të gushtit, në verë e në shi duke komanduar një trafik të çmendur, por që në fakt nuk është çmenduria e njerëzve, por është ajo çfarë ne e shohim me dhimbje gjatë këtyre viteve, një neglizhencë e theksuar për të investuar për këtë qytet dhe për të mirën e njerëzve.

Ku i kemi deputetët e opozitës dhe ku i kemi deputetët e pozitës, madje edhe në xhami mund të jetë ndonjëri prej tyre. Nuk është meseleja për të kritikuar apo për të gjuajtur me shigjetë, jo! Kjo është thirrja e Myftiut të Shkodrës, e një imami, e një besimtari dhe e një qytetari të thjeshtë për të mirën e kësaj toke dhe të këtij vendi!

Kanë kaluar 31 vite dhe ne mburremi me gjëra që nuk kanë asnjë vlerë dhe asnjë lloj dobie as për shoqërinë, as për vendin, për të na njohur dikush se kemi thënë këtë apo atë. Realitetet e vendit janë këto!

Nëse dilni tani nga Parruca deri në fund të Xhabijes, apo nga këtu ku jemi deri në Rus, do shihni rrugë që nuk i sheh as në vendet më të prapambetura të globit. Pse të dashurit e mi?

Nuk i ka borxh kjo shoqëri dhe këta njerëz askujt prej tarafeve të politikës së këtij vendi, të dëgjojë deklaratat e çoroditura kundër njëri-tjetrit. Këto mbajini për vete të dashur drejtues të këtij vendi dhe zgjidhini mes vete. Njerëzve, të cilët ju kanë votuar për të drejtuar këtë vend, duhen ofruar shërbime për të mirën e jetës së tyre.

Para pak ditëve desh përplaseshim me ambulancën diku në rrugë, jo për fajin tonë as për fajin e shoferit të ambulancës, por sepse nuk ka rrugë për të lëvizur. Po ashtu zjarrfikësja, e makina të ndryshme, motorra, biçikleta e këmbësorë të hutuar.

Viti 2021 dhe themi se ka dekada që kemi dalë nga komunizmi, ndërkohë që ka vende që kanë qenë në mjerim të thellë, dhe në më pak vite sesa vitet e post-komunizmit tonë janë bërë ndër vendet më luksoze të botës.

Allahu e bëftë mirë dhe i zgjoftë nga gjumi i hutisë ata që kanë në dorë për të bërë diçka dhe nuk e bëjnë. I zgjoftë nga gjumi i hutisë dhe i marrakotjes edhe njerëzit vetë që kanë në dorë për të bërë shumë, por i kanë bërë të jenë neglizhent ndaj hakut të tyre.

Haku i gjithsecilit prej nesh, në momente të tilla, është të themi një fjalë të mirë, duke iu lutur Allahut (xh. sh) për të na bërë të gjithëve çelësa të së mirës dhe drynj të së keqes për të mirën e kësaj toke, e të kësaj shoqërie!"

(Pjesë e shkëputur nga hytbeja e xhumasë, më 27 gusht 2021, në xhaminë e "Dy Vajzave")

MESAZH ME RASTIN E FILLIMIT TË VITIT TË RI HIXHRI 1443

Të dashur besimtarë!

Në jetën e njeriut ka momente, në të cilat vlen reflektimi dhe bërja e llogarive, për të parë se ku ishim e ku jemi, për të planifikuar se çfarë duam e çfarë na duhet për të ardhmen e afërt e atë të largët.

Pa dyshim, fillimi i vitit të ri hixhri, ndryshe përkujtimi i hixhretit, është një ndër këto momente të mrekullueshme, që na mbajnë të lidhur me identitetin dhe cakun tonë, vlerësimin e tyre dhe respektimin e vetes për besimin dhe shenjtërinë e tij, mbi të cilin nuk ka as duhet të jetë asgjë, për asnjë shkak e për asnjë arsye!

Falë hixhretit, mësuam të ruajmë ekuilibrat e traditave, tabanit, dijes, dinjitetit të atyre që na mësuan e baballarëve kryelartë, si dhe të mos nënshtrohemi para sektarëve e hizmetqarëve të devijuar, që thërrasin drejt një fetarizmi pa jetë, pa ngjyrë, pa shije; që krijon një bashkësi e komunitet pa dinjitet, pa krenari, pa bosht moral e pa vizion për të ardhmen!

Hixhreti, largimi i Resulullahut (paqja qoftë mbi të), nga vendlindja drejt Medines së Ndriçuar, pas 13 vitesh të ngarkuara me sakrificë e përkushtim, dashuri e dhimbje, punë e palodhur e angazhime, është një ngjarje, që siç e kanë shkruar dijetarët tanë: "ka ndryshuar rrjedhat e historisë së njerëzimit"!

Që do të thotë se sikur plani i idhujtarëve beduinë të ishte realizuar me sukses dhe i Dërguari i Zotit të ishte eliminuar fizikisht, bota nuk do të përfshihej në atë revolucion të pashembullt shpirtëror e moral, intelektual e zhvillimor, që i ndryshoi botës rrjedhën e jetës, duke e nxjerrë nga errësirat e idhujtarisë, kthetrat e bestytnive, prapambetja intelektuale, zullumet e mesjetës, luftërat e dhunshme e padrejtësitë e përhapura nga mungesa e ekuilibrave dhe humbja e busullës!

Falë hixhretit, bota mësoi të vlerësojë jetën, të respektojë lirinë e përzgjedhjes, të dënojë devijimin dhe prishjen e ekuilibrave të natyrës së pastër në të cilën na krijoi Zoti, të vlerësojë mendjen dhe aftësitë e fituara, të ketë mëshirën parim jete, të mos pranojë skllavërinë e vasalitetin, të jetojë me nder e krenari, të sakrifikojë për të mirën e ta konsiderojë përkushtimin për të ndërtuar jetën xhihad të shenjtë, të zhvillojë ura komunikimi me tjetrin në barazi e dinjitet, të ruajë fenë, jetën, mendjen, nderin e pasurinë, si pesë shenjtëri, për të cilat nuk bëhet kompromis as kalohet kufiri i tolerancës!

Falë hixhretit, mësuam të duam për tjetrin atë që duam për veten, të respektojmë urdhëresat hyjnore e të kemi mëshirë për krijesat e Zotit, të edukojmë fëmijët tanë me dashninë e Zotit, jo me tekat e devijuara të diktuesve të së keqes, të ndërtojmë të sotmen me dritën e besimit e largpamësinë e tij, jo me agjendat e shkatërruesve të jetës e tërheqjes së njerëzimit drejt greminave të degjenerimit, sëmundjeve, krimit, drogës, hutimit e mpirjes së mendjes!

Falë hixhretit, mësuam të ruajmë ekuilibrat e traditave, tabanit, dijes, dinjitetit të atyre që na mësuan e baballarëve kryelartë, si dhe të mos nënshtrohemi para sektarëve e hizmetqarëve të devijuar, që thërrasin drejt një fetarizmi pa jetë, pa ngjyrë, pa shije; që krijon një bashkësi e komunitet pa dinjitet, pa krenari, pa bosht moral e pa vizion për të ardhmen!

Ju ftoj me zemër ta lexojmë hixhretin si një mrekulli, që na mban të lidhur përherë e më shumë pas krenarisë e dinjitetit tonë, Islamit tonë, me të cilin, Krijuesi i gjithësisë na nxori nga errësirat në dritë, nga poshtërimi në krenari!

1443, qoftë vit i mbarë e plot sihariqe për mbarë njerëzinë!

Imam Muhamed B. Sytari
Myfti i Zonës Shkodër
Shkodër, 8 gusht 2021

"GUR VARRESH, GDHENDJE IDENTITETI..!

Në momente të caktuara, të pastrosh gur varresh që në heshtjen e tyre të akullt dëshmojnë për madhështinë e identitetit, është më e dobishme sesa të dëgjosh një pafundësi ligjërimesh misionare mbi ndërrimin e identitetit, ndalimin e ezanit, gërricjet e të kompleksuarve nga legjendat e "pushtimeve me gjysëm hënë", qokat e panevojshme të deklarimeve të pamatura, që mbajnë erën e urrejtjes së fshehur, të panevojshme dhe jologjike ndaj Islamit dhe muslimanëve, etj..!?

Ruajeni me fanatizëm e xhelozi identitetin e vlerave dhe mos u tundoni nga reklamuesit e tjetërsimit!

Shkodër, 19 gusht 2021

HIXHRETI ËSHTË SISTEM JETE, A JEMI NE MUHAXHIRË?

Në këtë muaj të parë të kalendarit hixhri 1443, mbarë bota islame në rrëmujën e saj, përkujtoi, a kaloi në mjegullnajën e realiteteve të veta hixhretin, ndryshe emigrimin e Resulullahut (paqja e Allahut qoftë mbi të) dhe besnikut të tij, Hz. Ebu Bekrit (Allahu qoftë i kënaqur me të), nga vendlindja e shtrenjtë drejt Medines së Ndriçuar.

Kryefjalë e shumë tubimeve, konferencave, hytbeve, derseve e bisedave u bë hixhreti; arsyet, shkaqet, mësimet, urtësitë, pasojat e rezultatet afatshkurtra e afatgjata të tij.

Në thelb, ymeti i Hixhretit është ymet i planifikimit dhe i ndjekjes së shkaqeve që çojnë drejt sukseseve në jetë!

Ai që ia mundësoi të Dërguarit të Tij udhëtimin në një pjesë të vogël të natës, nga Meka në Kudsi Sherifë, patjetër që mund t'ia mundësonte të njëjtin udhëtim nga Meka në Medine, por jo!

Udhëtimi i natës së Hixhretit ishte jo vetëm i detajuar, por i rrethuar me peripeci, vështirësi, lodhje, stërmundime e rrezik për jetën e disa personazheve kyçe, përfshirë Resulullahun!

A nuk është kjo ngjarje e madhe, për të cilën Dr. Sheuki Ebu Khalil shkruan: "Hixhreti, ngjarja që ndryshoi rrjedhat e historisë së njerëzimit", një ftesë reflektimi i vazhdueshëm për krejt shoqëritë muslimane dhe ymetin në vetvete?

Por, a ka justifikim për realitetet e sotme në të cilat përpëlitemi ne si muslimanë, bota e jonë shqiptare dhe mbarë ymeti islam në raport me botëkuptimin e Hixhretit?

Po lexoj këto ditë thirrje denigruese për ndalimin e ezanit, njësoj si provokimet tinzare të dikujt që ia kanë kurdisur orën te legjenda e "pushtimit barbar të gjysmëhënës osmane" dhe që sillet e përdridhet rreth asaj legjende fakire duke u rropatur për të rekrutuar të hutuar drejt trushpëlarjes, njësoj si disa që i dëgjoj të thërrasin për domosdoshmërinë e reformimit të ligjërimit fetar e, që në fakt fsheh pabesinë sektare të atyre, që kanë shitur shpirtin tek mentorët e kollarisur, që programojnë prej dekadash zhveshjen e Islamit e muslimanëve prej thelbit të rimëkëmbjes e rizgjimit drejt shkaqeve të organizmit mbi bazat e thirrjes së shenjtë të mësimeve të Hixhretit!

Kur dikush e pyeti Resulullahun (a.s.) për thelbin e botëkuptimit të hixhretit dhe se a ishte ai thjeshtë një largim fizik e material nga vendlindja, apo i lidhur ngusht pas një vendi, apo i posaçëm për një popull të caktuar, apo mbaronte me vdekjen e vetë pejgamberit (a.s.); ai zotni (a.s.) iu përgjigj: "Hixhreti është të largohesh nga veprimet e shëmtuara, të dukshme a të fshehta qofshin! Pastaj, në këtë mënyrë ti je muhaxhir, edhe nëse vdes në vendin tënd!".

Kjo do të thotë se Hixhreti është sistem jete, që nxit muslimanët drejt përmirësimit të vazhdueshëm dhe përpjekjeve të pandërprera drejt përsosmërisë individuale e shoqërore, duke e shtruar jetën sipas udhëzimit të Allahut, Zotit të vërtetë të gjithësisë!

Me fjalë të tjera, sot, teksa flasim e rikujtojmë Hixhretin e Ma të Mirit të njerëzisë, jemi të ftuar të bëhemi përditë e më shumë muhaxhirë në marrëdhëniet e komunikimin tonë të brendshëm e të jashtëm, në mënyrë që të shijojmë e të dëshmohet nëpërmjet nesh madhështia e udhëzimit hyjnor në jetën e përditshme!

Krejt çështja është: A jemi ne të gatshëm të bëhemi përditë e më shumë muslimanë aktivë, muhaxhirë të përkushtuar e besimtarë praktikantë të asaj që e besojmë dhe e themi me të madhe?

Imam Muhamed B. Sytari
Shkodër, 24 gusht 2021

AI KA BEZDI NGA EZANI, UNË LUTEM PËR TË!

Sot, dua të ndalem tek kritika që i bën Hafiz Ali Kraja, afetarizmit, si një dëm i madh individual dhe rrezik ekstrem për shoqërinë.

Islami nuk është "ideologji obskure reaksionare", siç shkruan përçart Mustafa Nano, që natyrshëm nuk është as fillimi, as fundi i botës e, që herë pas here merr shkas nga ndodhi banale në provincialitetin e metropolit shqiptar, për të rindezur debate jointelektuale që në thelb kanë goditjen e esencës së tabanit tonë kombëtar; Islamin!

Po risjell në vëmendjen tuaj një vështrim që pata publikuar para ca kohësh, që gjithësesi ka të bëjë edhe me shfaqjet e dhunshme të afetarizmit me kahje islamofobe tek ne në Shqipëri.

Më tërheq jashtë mase personaliteti i Hoxhës së nderuar shkodran, Hafiz Ali Kraja (1898-1974). Shkrimet e tij periodike, sidomos në revistën "Zani i Naltë", janë objekt studimi për teologët e rinj, studiuesit e filozofisë, intelektualët e përtej tyre.

Sot, dua të ndalem tek kritika që i bën Hafiz Ali Kraja, afetarizmit, si një dëm i madh individual dhe rrezik ekstrem për shoqërinë.

Duke parë degradimin e realiteteve shqiptare, si pasojë e politikave afetare dhe islamofobe, si dhe deformimin e shumë koncepteve mbi fenë, moralin, demokracinë, lirinë, drejtësinë, paqen, harmoninë, trashëgiminë shpirtërore e kulturore etj, mendoj se fjalët e Hoxhës së nderuar, vazhdojnë të jenë akoma në koherencë me këto zhvillime për kombin dhe të ardhmen e tij!

Kjo do të thotë se detyra e muslimanëve shqiptarë karshi fesë dhe kombit të tyre është shumë më e madhe, sesa përfaqësimi me paterica dhe jo dinjitoz, izolimi në jetën e xhamisë, fetarizmi i fjetur e i rëndomtë dhe partishmëria parazite ndaj erërave të ndryshme, që fryjnë sa andej-këndej, pa pasur paraprakisht një bosht të mirëfilltë strategjik dhe një shtyllë kurrizore identitare!

"Besimi mban rregullimin dhe harmoninë e shoqërisë njerëzore. Shoqëria paraqet një trup, pjesëtarët e të cilit janë në harmoni me atë vend ku respektohen rregullat e moralit. Në pikëpamje morale, kjo harmoni e ka burimin në përbashkësinë e ndjenjave, si fetare ashtu edhe të tjera, të personave që përbëjnë shoqërinë. Po ta heqim Besimin prej mjedisit, kjo harmoni shuhet vetvetiu.

...

Afetarizmi është një rrezik si për shoqëri ashtu për pjesëtarët e saj që janë fetarë. Besimi, pra, është gurra e cila ia bën të këndshme jetën njeriut dhe i jep atij shpresa për lumturi. Ai që është larg kësaj gurre është fatmjerë dhe sikur t'i zotërojë të gjitha mjetet materiale që i duhen në këtë jetë; ai është i mjerë se i mungojnë ndjenjat e larta morale të cilat do ta bënin atë të lumtur.

...

Afetarizmi nuk është vetëm një mjet shkatërrues për veten dhe për shoqërinë, por njëherazi edhe për familjen. Vetëm interesi e lidh afetarin me familje.

...

Se Besimi është një nevojë për shoqërinë njerëzore dhe se njerëzit pa Besim nuk mund të jetojnë në formë të shoqërisë, u tregua edhe në manifestimet tragjikomike në kohën e revolucionit të madh francez...

Me të vërtetë, atë ditë që të fiket ideja e Besimit, po atë ditë njerëzimi është plandosur në humnerë të shkatërrimit." - (Hafiz Ali Kraja, "A duhet Feja, a e pengon bashkimin kombëtar", ribotimi i KMSh-së,Tiranë, 2010, f. 18-21. Botimi i parë, Shkodër, 1934.)

Dialogu dhe hapja me tjetrin, mund të ishte një mundësi e mirë e ballafaqimit të mendimeve, ideve, besimeve e vokacioneve të ndryshme shpirtërore e kulturore, në rrugën e qartësimit të interesave të ndershme e të shëndosha kombëtare!

Imam Muhamed Bardhyl Sytari
Shkodër, më 20 gusht 2016 - 2021

Shejkh Muhamed El-Gazali
(1917 - 1996)

"Qëllohemi ashpër dhe me forcë, sepse jemi në fazën e zgjimit, sikur të ishim të vdekur, nuk do të na qëllonin kaq fort!"

VETËVRASJA SI NJË PLAGË E DHIMBSHME E SHOQËRISË SONË

Mr. Nehat Ismaili,
Imam - Xhamia e Bardhë, Aarburg - Zvicër

Vetëvrasja është një nga temat më komplekse, më të dhimbshme dhe më shqetësuese në botë, një temë që ka impakt të thellë kulturor dhe shoqëror, e cila merr shumë forma dhe trajta, prek të gjitha shoqëritë, të gjitha grupmoshat dhe të gjitha nivelet kulturore. Studimi i fenomenit të vetëvrasjes kërkon dekonspirimin e jetës së një shoqërie të tërë në të gjitha nivelet fetare, politike, ekonomike, sociale, estetike dhe psikologjike për të njohur detajet e jetës së ndryshme dhe të shumta të individëve.

Fenomeni i vetëvrasjes në shoqëritë perëndimore është studiuar më parë, kështu që gjejmë, për shembull, nga Max Weber, i cili studioi fenomenin e vetëvrasjes në shoqërinë gjermane, zbuloi se vetëvrasja midis çifteve të martuar që nuk kanë fëmijë është më e lartë se ata çifte që kanë fëmijë. Por pyetjet që lindin sot në shoqërinë shqiptare: A është vetëvrasja për shkak të një ndjenje të tepruar inferioriteti për shkak të presioneve materiale dhe imponimit të një rendi jetësor që dëmton dinjitetin njerëzor? Apo vetëvrasja është për shkak të natyrës së shëndetit shoqëror dhe psikologjik të lidhur me sistemin bashkëkohor të konsumit në periudhën e globalizmit?

Jeta bazohet në ekuilibër dhe në një sistem ekonomik, shoqëror dhe kulturor të qenësishëm të njeriut, dhe që mbulon kërkesat materiale, morale dhe shëndetësore të jetës së tij. Vetëvrasja do të thotë zhdukje e këtij ekuilibri nga sistemi i jetës dhe ndjenja e bllokimit të rrugës së jetës, me të cilën personi humb veçorinë dalluese, dhe në të cilën mendja është e barabartë me emocionet dhe është i bindur të heqë dorë nga e drejta për jetë, sepse jeta i është bërë rutinë duke parë vdekjen si mëshirë në mungesë të një shpëtimtari, dhe për të është i parëndësishëm ndikimi negativ dhe traumat që do të shkaktojë vetëvrasja e tij në rrethin familjar.

Struktura e qenies njerëzore si tërësi kërkon angazhimin e njeriut në mënyrë permanente. Besimi fetar u përkujdes për të për të gjitha fazat e jetës, e porositi atë që nga mosha e fëmijërisë të mësoj shkrim leximin, nga mosha madhore të praktikojë lutjet fetare, nga mosha e postadoleshencës të angazhohet aktivitete dhe punë primare, e udhëzoi atë që të njekë një sistem të ekuilibruar të jetës, midis plotësimit të kërkesave të natyrshme për veshmbathje, për t'u ushqyer, për edukim, arsimim, tregti, avansim në jetën profesionale, për të qenë aktor aktiv në jetën sociale, kulturore, politike, si dhe në anën tjetër duke mos harruar asnjëherë aspektin shpirtëror shumë të rëndësishëm, meditim mbi jetën përtej vdekjes, mbi parajsën si një shpërblim madhor dhe qëllim final për një besimtar për shkak të përkushtimit dhe dinjitetit të tij, që veprimtaria e tij ka qenë në përputhshmëri me vullnetin hyjnor të Zotit të Gjithësisë.

Në periudhën moderne, metodologjia e shumicës së individëve bazuar në dritën e lirisë për të përzgjedhur një sistem për jetën individuale sipas organizatave për të drejtat e njeriut, të cilat në shumë raste vendosën qëllime të paqëndrueshme dhe të paarsyeshme, madje të gjitha qëllimet i kufizuan në materializëm dhe estetikë në kurriz të vlerave shpirtërore, dhe si pasojë kemi shumë projekte të dështuara të martesave dhe marrëdhënieve ndërnjerëzore, me ç'rast funksionimi i strukturës njerëzore shfrytëzohet në mungesë të një të impulsi fetar dhe moral.

Gjithashtu, shkenca ka provuar që sistemi i konsumit ka një impakt në jetën e njeriut, dhe kjo ka shkaktuar përhapjen e sëmundjeve psikologjike dhe organike në ndërkohë në periudhën e fundit janë zbuluar edhe sëmundjet mendore që shumica e njerëzve janë të prekur nga këto simptome të depresionit të thellë dhe sëmundjeve të ndryshme psikologjike, si pasojë një numër i madh i këtyre çrregullimeve psikologjike janë vështirë për t'u trajtuar dhe ndonjëherë përfundojnë me vetëvrasje.

Vetëvrasësi arrin në një gjendje të tillë shpirtërore dhe mendore saqë ai nuk e ndjen se ka fëmijë të vegjël nëse është i martuar dhe ka fëmijë, ose prindër apo familje. Ai nuk e ndjen vlerën e tij shpirtërore nëse nuk është fetar dhe nuk e ndjen Krijuesin e tij i cili ndalon të bëjë diçka që dëmton qëllimet nëse nuk është monoteist. Psikika dhe mendja e vetëvrasësit kthehen në një ndjenjë të errët, melankolike të përkëdhelur nga dëshpërimi, zhgënjimi, depresioni, në një gjendje shpirtërore të zymtë e të rënë që është pushtuar nga një trishtim i thellë, i trishtuar deri në palcë, i paaftë për t'i bërë ballë problemeve dhe për të shikuar në ballë realitetin.

Vetëvrasjet në epokën moderne janë shtuar aq tepër saqë shifrat janë alarmante. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, bazuar në statistikat e saj në nivel botëror, raporton mbi 800 000 raste në vit nga vetëvrasjet në nivel global dhe se vetëvrasja është shkaku i tretë i vdekjes për njerëzit midis moshës 15 dhe 19 vjeç.

Vetëvrasjet në epokën moderne janë shtuar aq tepër saqë shifrat janë alarmante. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, bazuar në statistikat e saj në nivel botëror, raporton mbi 800 000 raste në vit nga vetëvrasjet në nivel global dhe se vetëvrasja është shkaku i tretë i vdekjes për njerëzit midis moshës 15 dhe 19 vjeç, gjithashtu vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme zënë 79% të vetëvrasjeve në botë.[1] Në Shqipëri gjendja është alarmante, dhe sipas burimeve të policisë së shtetit të cilët për revistën «Monitor»konfirmuan se numri i vetëvrasjeve në vitin 2018 në total ka qenë 183 ndërsa i vrasjeve 68, për të mos folur për tentimet e dështuara për vetëvrasje që kapin shifra marramendëse.[2]

A ka ndryshuar bota përreth nesh? A mos vallë shija e jetës është bërë e hidhur ndërsa e vetëvrasjes së imponuar është bërë e ëmbël?! Apo kemi hyrë në epokën e modës së vdekjes së papritur në mënyra dhe rrethana misterioze? A i ka ardhur fundi epokës së ambicies dhe ëndrrës për avansim profesional apo jemi të tunduar dhe pushtuar nga serialet kinematografike të jetës bolivudiane të vetë-hakmarrjes si mëkat që shkakton vrasjen dhe vetëvrasjen?! A mos vallë ka vdekur ndërgjegjja jonë?! A mos vallë roli i fesë ka vdekur dhe bashkë me të kanë vdekur edhe vlerat e kulturës në shoqërinë tonë, saqë që dëshira për të bërë vetëvrasje është bërë një çështje normale?

Apo ndoshta ka përfunduar epoka e monitorimit dhe ndjekjes morale të jetës së përditshme të qytetarëve, të cilët vuajnë nga problemet psikike, që janë të varur nga konsumimi i ilaçeve, të cilët kanë nevojë për trajtim dinjitoz dhe monitorim permanent të tyre, për t'ua lehtësuar atyre vuajtjet ekonomike dhe sociale, sidomos në periudhën e pandemisë së koronavirusit por besa edhe pas pandemisë e cila do të shkaktojë shkarje edhe më të thella në shoqëri dhe do të prekë fundin e xhepin e qytetarit të varfër, duke i shkaktuar trauma të mëtejshme.

Në përgjithësi dhe ajo që duket të jetë ndër shkaqet që çojnë në vetëvrasje, dhe që qëndrojnë në disa aspekte në studimin e fenomenit me qasje të ndryshme për të arritur të vërtetën duke filluar nga supozimi se struktura e shoqërisë është indolente dhe painteresuar. Ftohja e marrëdhënieve familjare ka shkaktuar një krizë brenda familjes e cila më nuk është një strehë e ngrohtë dhe e sigurt, mungesa e shpresës për një të ardhme më të mire në një shoqëri që perceptohet si e rraskapitur dhe dërmuar kulturalisht dhe ekonomikisht, që shkakton depresion dhe kryesisht sëmundje psikologjike, po ashtu supozimi se shoqëria është e rezervuar për fenomenet dhe anomalitë e tilla të cilat qëllimisht fshihen dhe heshtën, dhe se fenomeni i vetëvrasjes fsheh mjerimin shpirtëror të shoqërisë moderne të ngritur mbi bazën e materializmit.

S'do mend që presionet ekonomike dhe kushtet e këqija materiale kanë një ndikim në jetën e individëve, pasi kostot materiale të konsumit janë rritur në këmbim të shpërndarjes së dobët të pasurisë, mungesës së të ardhurave dhe më pak mundësi pune, e cila ka shkaktuar varfërinë, dhe bashkë me të edhe vështirësinë e jetës dhe vështirësitë për të arritur kërkesat e një jetese të denjë. Vetëvrasja është alarmante edhe në shoqëritë e zhvilluara kapitaliste ku nuk mungojnë luksi dhe komoditeti por si pasojë e konsumimit të substancave narkorike, alkoolit, depresionit të thellë etj.

Vetëvrasja sipas besimit islam është rreptësisht e ndaluar, është krim i pafalshëm, është turp dhe njollë e zezë për vetëvrasësin. Vetëvrasësi jo vetëm që ka vrarë vetveten por me aktin e tij të turpshëm ka vrarë edhe familjen e tij duke u shkaktuar trauma të përjetshme. Vetëvrasja është një nga shtatë mëkatet më të mëdha që shkatërrojnë individin dhe shoqërinë

"O ju që besuat, mos e hani mallin e njëri-tjetrit në mënyrë të palejuar, përpos tregtisë në të cilën keni pajtueshmëri mes vete, dhe mos mbytni veten tuaj (duke mbytur njëri-tjetrin). Vërtet, All-llahu është i Mëshirueshëm për ju". [Kuran 4:29].

Vetëvrasja sipas besimit islam është rreptësisht e ndaluar, është krim i pafalshëm, është turp dhe njollë e zezë për vetëvrasësin. Vetëvrasësi jo vetëm që ka vrarë vetveten por me aktin e tij të turpshëm ka vrarë edhe familjen e tij duke u shkaktuar trauma të përjetshme. Vetëvrasja është një nga shtatë mëkatet më të mëdha që shkatërrojnë individin dhe shoqërinë, dhe kjo më së miri pasqyrohet në një thënie të profetit Muhammed, paqja e Zotit qoftë mbi të kur shprehet: "Qëndroni larg shtatë mëkateve shkatërruese për njeriun...Politeizmi ndaj Zotit, vrasja dhe vetëvrasja, ngrënia e pasurisë së jetimit, arratisja nga lufta, shpifja për amoralitet për një grua të ndershme"

Presionet sociale llogariten nga çështjet më komplekse për shkak të lidhjes së tyre me jetën familjare, lidhjet farefisnore, martesat dhe manifestimet e dhunës që rezultojnë në divorc, prishjen e marrëdhënieve që prodhojnë divorc, zhvendosjen e fëmijëve për arsye të parëndësishme, rritjen e dukurisë së tradhtisë, prishjen e familjeve dhe çrregullimin e jetës emocionale dhe seksuale midis individëve si dhe shqetësimin psikologjik dhe shëndetësor.

"Ju mos i mbytni fëmijët tuaj nga frika e varfërisë, se Ne ua sigurojmë furnizimin atyre dhe juve, e mbytja e tyre është mëkat i madh". [Kuran 17:31]

Po ashtu faktor i rëndësishëm është zbrazëtia dhe vakumi shpirtëror, largësia nga njohja e Zotit si Krijuesi i Universit, mosrespektimi i fesë në të gjitha nivelet e shoqërisë dhe mbajtja e rritjes së fëmijëve larg shtegut të qëllimeve më të rëndësishme në jetë, të tilla si ruajtja e shpirtit, ruajtja e fesë, ruajtja e mendjes, ruajtja e pasardhësve dhe ruajtja e kapitalit. Madje shumë individë të painformuar drejtë e konsiderojnë braktisjen e fesë një arsye për të mos mbetur në rrethin e varfërisë e cila nuk ofron zgjidhje materiale për kërkesat e jetës dhe ato e kufizuan funksionin e fesë në adhurim dhe praktikat rituale rutinore ... E gjithë kjo mungesë ka krijuar një vakum në jetën e individëve dhe ka tharë marrëdhëniet dhe raportet, ku tërheqja e rëndësishme shpirtërore e individëve dhe mungesa e besimit fetar në jetën e individëve çon në endje, thyerje, humbje të shijes për jetën, si dhe lehtëson që individi të preket nga depresioni dhe dëshpërimi, për shkak të ndarjes së qëllimit material në jetë nga qëllimet fisnike dhe fitimit moral.

Krejt në fund, psikologët sugjerojnë dhe të gjithë duhet ta dimë se çrregullimet psikologjike kanë një ndikim shkatërrues në kualitetin e jetës me konsenkvenca serioze në nivel personal, emocional, familjar dhe social. Njerëzit me simptome dhe probleme të tilla duhet të konsultohen me profesionistë të shëndetit mendor, dhe të trajtohen pasi neglizhimi dhe injorimi i këtyre simptomeve dhe problemeve në kohë mund të çojë në akte ekstreme si vetëvrasja.

Arsyeja e parë e vetëvrasjes mbetet depresioni, sigurisht që nuk duhet nënvlerësuar asnjëherë edhe faktorët tjerë. Studimet e OBSH-së në vitin 2018 ngrenë shqetësimin dhe i mëshonin kambanave se depresioni do të jetë sëmundja e shekullit duke lënë në vend të dytë sëmundjet kardiovaskulare.

Përpjekjet për parandalimin e vetëvrasjes kërkojnë një koordinim dhe bashkëpunim të shumë sektorëve të shoqërisë, përfshirë sistemin shëndetësor, sistemin arsimor si dhe rolin e institucioneve fetare në vetëdijesimin dhe ndërgjegjësimin e individit dhe shoqërisë.

Besimi në Zot, praktikimi i fesë si dhe meditimi në natyrë janë ilaçi më i mirë për shërimin e depresionit dhe parandalimit të vetëvrasjes.

---

[1] https://www.who.int/ar/news-room/fact-sheets/detail/suicide
[2]https://www.monitor.al/vetevrasjet-tre-here-me-te-larta.../

DOBITË DHE MIRËSITË E ISTIGFARIT

REZULTATET POZITIVE TË ISTIGFARIT

Ebu Seid Hudriu, (r.a), transmeton që i Dërguari i Allahut, (a.s), ka thënë: "Shejtani i thotë Allahut: 'Pasha madhërinë dhe lartësinë Tënde, unë do t'i mashtroj njerëzit derisa i kanë shpirtrat në trup'. Ndërsa Allahu i thotë: 'Pasha madhërinë dhe lartësinë Time, Unë do t'i falë pandërprerë derisa të më luten për falje'." - (Ahmedi)

Dhe jo vetëm kaq, por Allahu për shkak të mirësisë, fisnikërisë, mëshirës, bamirësisë, pas pendimit të sinqertë, veprat e këqija i kthen në vepra të mira siç tregon ajeti: "Përveç atij që është penduar dhe ka bërë vepër të mirë, të tillëve All-llahu të këqijat ua shndërron në të mira. All-llahu është mëshirues, ndaj Ai falë shumë." - (El - Furkan, 70)

Mirëpo, besimtari nuk duhet lehtë të sillet ndaj mëkateve për faktin se Allahu falë mëkatet, sepse Allahu është për ata që sinqerisht pendohen për mëkate. Në këtë kuptim tregon edhe ajeti: "Zoti juaj e di më së miri atë që keni në shpirtin tuaj. Nëse keni qëllime të mira, vërtet Ai u fal atyre që pendohen." - (El - Israë, 25)

Si dhe ajeti: "Nuk ka dyshim se Unë e fal atë që është penduar, që ka besuar, që ka bërë vepra të mira dhe që përqëndrohet për në rrugën e drejtë." - (Ta Ha, 82)

Kur besimtari di që Allahu i falë

> "Bëni shumë istigfar në shtëpitë tuaja, rrugëve, tregjeve, në ndeja, sepse ju nuk dini kur Allahu do ta zbresë magfiretin dhe faljen."

mëkatet, gjithashtu duhet të di që Allahu rekomandon që të përpiqet që të bëjë sa më shumë vepra të mira të cilat fshijnë mëkatet, të bëjë sa më tepër istigfar dhe t'i lutet Allahut për faljen e mëkateve, sepse istigfari (kërkimfalja) është rrugë e robërve të zgjedhur të Allahut.

ISTIGFARI ËSHTË RRUGË E ROBËRVE TË ZGJEDHUR TË ALLAHUT

Istigfar është kërkimfalje dhe magfiret nga Allahu dhe simbolizon balsam me të cilin njeriu shërohet nga helmet dhe sëmundjet e mëkateve.

Në gjuhën arabe për përkrenaren (helmetën) dhe pancirin të cilin e vendos ushtari përdoret termi "el-migfer", që d.m.th. mbrojtje nga shpata, shtiza apo plumbi në luftë.

Ndërsa ne jemi në luftë të përhershme me shejtanin dhe pasionet e nefsit, kështu istigfari është mburoja më e mirë.

Hasan Basriu, (r.a), ka thënë: "Bëni shumë istigfar në shtëpitë tuaja, rrugëve, tregjeve, në ndeja, sepse ju nuk dini kur Allahu do ta zbresë magfiretin dhe faljen."

Aisha, (r.a), ka thënë: "I lumi ai në librin e të cilit ka shumë istigfar."

Kur mëkatari, e gjithë jemi mëkatarë, qëndron para Zotit në namaz, e sidomos në namazin e natës dhe e thërret Zotin pas mëkateve të bëra të cilat i krijojnë dhembje dhe ngushllëk në gjoks, nuk e lënë të qetë, pasi që kupton se nuk ka shpëtim dhe strehim nga ky ngushllëk pos te Allahu dhe i lutet Atij me përulje, i bindur që vetëm Allahu është Ai i Cili i falë mëkatet, duke thënë: "O Allah i dashur, unë jam mëkatar, bëj mëkate ndaj Teje dhe zullum ndaj vetit, shejtani dhe nefsi im më kanë mashtruar, por unë kam uzda (besim) në madhërinë, mëshirën dhe mirësinë Tënde, jam kthyer te Ti i penduar duke kërkuar falje për mëkatet e mia, andaj më fal mëkatet e mia dhe mbi mbulo turpet e mia, sepse unë e di që përveç Teje askush nuk i falë mëkatet", shpejtë do t'i ndiejë (përjetojë) frytet e istigfarit të tij, do ta ndiejë mëshirën e Allahut, sepse Allahu pas pendimit nuk shikon çfarë ka qenë më parë, sa mëkate ka bërë njeriu, por i gëzohet teubes (pendimit) të robit, dhe i hap dyert e qiellit që fjalët e lutjes së tij të ngriten deri në qiellin e shtatë për t'i pranuar Ai, e pastaj u thotë melekëve: "O melekët e Mi, robi

> "Për Allahun, më të dashura janë tri vepra apo tri gjëra: falja në mundësinë e dënimit, mesatarja në pasuri dhe butësia apo mesatarja në ibadet. Askush nuk do tregojë butësi ndaj dikujt në dynja e që Allahu nuk do të jetë i butë ndaj tij në Ahiret."

Im di që ka Zot i Cili dënon për mëkate, por edhe është falës i mëkateve, andaj bëhuni dëshmitarë se e fala."

Ndoshta ai njeri ka 40, 50 apo 60 vjet por Allahu për një moment të teubes së sinqertë dhe pendimit ia falë të gjitha mëkatet pas së cilës shejtani hudh dhe mbi kokën e tij duke u pikëlluar dhe duke thënë: "I mjeri unë, e kam lajthitur 40 apo 50 vjet, ndërsa iu falën mëkatet për një moment."

VEPRAT QË JANË SHKAS I FALJES SË MËKATEVE

Ka shumë vepra të mira që janë shkas i magfiretit dhe faljes së Allahut, e në këto vepra pos istigfarit gjithsesi bën pjesë edhe lutja (duaja).

Lutja me përulësi dhe përkushtim është shenjë e pendimit të sinqertë, sepse Allahu nuk do më shumë se zërin e ulët dhe të përulur të mëkatarit se sa tesbihin dhe dhikrin me zë të lartë.

Pastaj, mirësia ndaj prindërve. Imam Buhariu në veprën e tij "Edebul mufred" shënon transmetimin nga Ata' ibn Jesar, në të cilin përmendet që një djalë erdhi te Abdullah ibn Abbasi, (r.a), dhe i tha: "Unë e kërkova dorën e një vajze që e dashuroja, por ajo u martua me një tjetër. Xhelozia më kaploi dhe unë e mbyta. A ka për mua pendim?" Ibn Abbasi, (r.a), e pyeti: "A ke nënë?" "Jo", u përgjigj. Pastaj i tha: "Pendohu tek Allahu dhe bën shumë vepra të mira, ndoshta Allahu do të falë." Kur shkoi djaloshi, Ata' ibn Jesari e pyeti Ibn Abbasin: "Përse e pyete se a ka nënë?", ndërsa ai i tha: "Pasha Allahun, unë nuk di vepër e cila më shumë ofron te Allahu se sa bamirësia ndaj nënës."

Pastaj, veprat që janë shkas i faljes së mëkateve nga Allahu janë mendimi i mirë për myslimanët, pastërtia e zemrës dhe falja e atij që të ka bërë keq.

Transmetohet që Abdullah ibn Mes'udi, (r.a), njëherë kishte shkuar në treg për të shitur mallin e tij dhe një hajdut ia vodhi të hollat nga turbani. Njerëzit i thanë: "Lutu kundër tij pasi t'i vodhi të hollat." Ibn Mes'udi e bëri këtë lutje: "O Allah i dashur, nëse nevoja e ka shtyrë që t'i marrë të hollat e mia, jepi bereqet në këtë, e nëse i ka vjedhur të hollat e mia pa pasur nevojë, bëje që ky të jetë mëkati i fundit." - (Ihja ulumid-din, III/196)

Omer ibn Abdulazizi thoshte: "Për Allahun, më të dashura janë tri vepra apo tri gjëra: falja në mundësinë e dënimit, mesatarja në pasuri dhe butësia apo mesatarja në ibadet. Askush nuk do tregojë butësi ndaj dikujt në dynja e që Allahu nuk do të jetë i butë ndaj tij në Ahiret."

Pastaj, mbulesa e turpeve të tjerëve. Pasi që magfireti në vete përbën mbulesën e mëkateve dhe turpeve. Njëra prej lutjeve të Davudit, a.s., ka qenë: "O Allahu im, kërkoj mbrojtje nga Ti prej komshiut të keq, sytë e të cilit më shikojnë, veshët e të cilit më dëgjojnë, i cili kur e sheh të mirën tek unë e fsheh, por kur sheh diç të keqe e përhap." - (Imam Taberaniu, Mu'xhemul-evsat, hadithi nr. 6180)

Është pyetur Ebu Temim el-Huxhejmi: "Si je gdhirë?" U përgjigj: "Jam gdhirë me dy begati dhe nuk di cila prej tyre është më e mirë. Allahu mi ka mbuluar turpet dhe nuk frikësohem që dikush për shkak të këtyre turpeve do të më bëjë me gisht, dhe më bëri që njerëzit të tregojnë dashurinë ndaj meje të cilën nuk e kam merituar me veprat e mia, por me mirësinë e Zotit të botëve." - (Shuabul-iman, 6/288)

Lutemi Allahut, Atij që Veten e ka quajtur El-Gafir, El-Gafur dhe El-Gaffar, që të na falë mëkatet dhe mbulojë turpet tona në dynja dhe në Ahiret, që të na mbulojë me magfiretin dhe faljen e Tij në ditën e Gjykimit dhe neve dhe familjat tona të na gëzojë me shpërblimin e përhershëm në Xhenet.

Amin

Përktheu dhe përshtati:
Prim.dr.med.sc. Ali F. Iljazi



I Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë:

"

EBU HUREJRA (R.A) TRANSMETON SE PEJGAMBERI (A.S) I KA THËNË:

1. RUAJU PREJ HARAMEVE, DO TË JESH NJERIU MË ADHURUES,

2. KËNAQU ME ATË QË ZOTI TË KA CAKTUAR, DO TË JESH NJERIU MË I PASUR,

3. BËJI MIRË KOMSHIUT, DO TË JESH BESIMTAR,

4. DËSHIROJI NJERËZVE ATË QË DËSHIRON PËR VETËN TËNDE, DO TË JESH MYSLIMAN,

5. MOS QESH SHUMË, SE TË QESHURIT E TEPËRT MBYT ZEMRËN.

"

(Transmetuar nga Ahmedi dhe Tirmidhiu)

NIGERIA
OSE REPUBLIKA FEDERALE E NIGERISË

Nigeria, ose zyrtarisht Republika Federale e Nigerisë, është një shtet që ndodhet në bregun perëndimor të Afrikës, dhe kufizohet me Nigerin në veri, me Çadin në verilindje, me Kamerunin në lindje,me Beninin në perëndim, dhe në jug me Gjirin e Guinesë (të Oqeanit Atlantik).

Nigeria është një republikë federale, që përfshin 36 shtete si edhe Territorin e Kryeqytetit Federal, ku ndodhet kryeqyteti Abuxha. Qyteti më i madh në Nigeri është Lagos, që është edhe një nga zonat më të mëdha metropolitane në botë, dhe e dyta më e madhe në Afrikë.

Nigeria ka një sipërfaqe 923.768 km2, dhe një popullsi prej 212.256.688 banorësh (sipas worldometers.info, Gusht 2021).

GJEOGRAFIA

Në përgjithësi, topografia e Nigerisë përbëhet nga fusha në veri dhe në jug, të ndërprera nga pllaja dhe kodra në qendër të vendit.

Pika më e lartë në Nigeri është Chappal Uaddi, që arrin në 2.419 m. Lumenjtë kryesorë të vendit janë Nigeri dhe Benue, të cilët bashkohen dhe derdhen në Deltën e Nigerit, e cila është një nga deltat më të mëdha të lumenjve në botë, si edhe vendndodhja e një zone të madhe të rizoforeve të Afrikës Qendrore.

Rajoni topografik më i shtrirë i Nigerisë është ai i luginave të lumenjve Niger dhe Benue, të cilat bashkohen duke formuar një formë Y-je. Jugperëndimi i Nigerit është një zonë malore e thyer. Në juglindje të lumit Benue, gjenden kodra dhe male, të cilat formojnë Rrafshnaltën Mambilla, që është edhe rrafshnalta më e lartë në Nigeri. Kjo rrafshnaltë shtrihet përmes kufirit me Kamerunin, ku zona malore e saj është pjesë e Lartësive Bamenda të Kamerunit.

KLIMA

Pjesën më të madhe të Nigerisë e mbizotëron klima tropikale, që është e ngrohtë shumicën e vitit. Megjithatë, rajonet veriore janë më të nxehta dhe më të thata se rajonet jugore. Temperatura mesatare në veri arrin në rreth 29° C, por temperatura ditore atje mund të arrijë në 38° C. Temperatura mesatare në rrafshnaltën Jos, në zonën qendrore të Nigerisë dhe në lartësisë lindore, është shumë më e ulët se në veri, për shkak të lartësisë së madhe të këtyre zonave mbi nivelin e detit. Në jugun e lagësht, i cili merr një proporcion më të madh të shiut sesa veriu, dhe ku mesatarja vjetore e shiut është rreth 381 cm në zonat bregdetare, temperatura mesatare vjetore është rreth 27° C. Sezoni i shirave, në shumicën e zonave të Nigerisë, zgjat nga prilli deri në tetor, kurse në jug të vendit ky sezon zgjat më shumë.

GJUHA

Nigeria ka më shumë se 250 grupe etnike, me gjuhë dhe zakone të ndryshme, duke krijuar kështu një vend me diversitet të pasur etnik. Tre grupet më të mëdha etnike atje janë Hausa, Joruba dhe Igbo, që së bashku përbëjnë më shumë se 70% të popullsisë.

Gjuha zyrtare në Nigeri është gjuha angleze, e cila mësohet në shkolla në të gjithë vendin, megjithatë, kjo nuk është gjuha më e përdorur gjerësisht atje. Secili prej më shumë se 250 grupeve kulturore që jetojnë në Nigeri, ka gjuhën e vet të veçantë, dhe ato që përdoren më së shumti nga të gjitha këto gjuhë janë tri: Hausa, Joruba dhe Igbo. Shumica e nigerianëve flasin më shumë se një gjuhë, dhe në shumicën e rasteve ata përdorin gjuhën e grupit të tyre etnik.

Muslimanët përdorin gjuhën arabe për të kryer ritet fetare, dhe shkrimi arab është përdor për të shkruar gjuhën Hausa, para se kjo gjë të bëhej e ndaluar nga kolonialistët anglezë.

FEJA

Feja kryesore në Nigeri është Islami, me 68% të popullsisë. 22% të popullatës janë të krishterë, dhe 10% janë grupe pagane. 100% e muslimanëve atje janë sunitë, ndjekës të shkollës malikite. Muslimanët janë të përqendruar më së shumti në veri dhe në jugperëndim të vendit. Disa shtete të Nigerisë kanë njoftuar edhe aplikimin e Sheriatit.

Grupet pagane janë të përqendruara në jug dhe në lindje, por ato janë drejt zhdukjes, pasi shumë prej tyre konvertohen në Islam ose në krishterizëm.

EKONOMIA

Ekonomia e Nigerisë konsiderohet një ekonomi në zhvillim. Edhe pse gati dy të tretat e punëtorëve në Nigeri janë të punësuar në bujqësi, produktet bujqësore përfaqësojnë vetëm rreth një të pestën e vlerës totale të të ardhurave kombëtare. Që nga fundi i viteve gjashtëdhjetë të shekullit të 20-të, minierat janë bërë aktiviteti më i rëndësishëm ekonomik, për shkak të përparimit të shpejtë në industritë e naftës, dhe përfaqësojnë 70% të të ardhurave në vend. Nigeria është një nga vendet më të rëndësishme prodhuese të naftës në botë, dhe nafta është një nga burimet natyrore më të rëndësishme në vend.

Fabrikat në Nigeri prodhojnë një gamë të gjerë të mallrave të ndryshëm, por numri i punëtorëve në sektorin industrial nuk e kalon 10% të totalit të fuqisë punëtore në vend. Industria gjithashtu përfaqëson më pak se 10% të të ardhurave kombëtare të Nigerisë.

Qeveritë federale dhe shtetërore kontrollojnë disa sektorë ekonomikë, të tillë si transporti dhe prodhimi i energjisë elektrike. Sektori privat zotëron shumicën e sektorëve industrial dhe të biznesit, por qeveria federale ndan pronësinë e disa prej tyre, dhe herë pas here lëshon plane zhvillimore kombëtare që përcaktojnë objektivat e rritjes ekonomike në vend.

Nigeria ka burime të ndryshme natyrore, dhe më shumë se gjysma e tokës së saj është e përshtatshme për bujqësi dhe kullota, por zona e përdorur në të vërtetë për rritjen e kulturave nuk e kalon 15% të sipërfaqes së përgjithshme të vendit, ndërkohë që pyjet mbulojnë gati një të tretën e sipërfaqes së tij. Liqenet dhe lumenjtë sigurojnë sasi të mëdha peshku, gjithashtu.

Nigeria zë një pozitë udhëheqëse në mesin e prodhuesve kryesorë të kakaos, vajit të palmës, frytit të palmës, të kikirikut dhe të gomës. Produkte të tjera të rëndësishme në Nigeri përfshijnë fasulet, misrin, pambukun, orizin, duhanin, etj. Dhitë, delet dhe shpendët gjithashtu rriten nga fermerët në të gjithë Nigerinë. Lopët rriten kryesisht në veri të vendit, ndërsa peshkatarët gjuajnë kryesisht karkalecat e detit, përveç llojeve të ndryshme të peshqve dhe gjallesave të ngrënshme që merren nga deti.

HISTORI

Zona që sot njihet si Nigeria, është banuar nga njeriu mijëra vjet më parë. Në disa pjesë të Nigerisë arkeologët kanë zbuluar mjete guri, mosha e të cilave konsiderohet të jetë më shumë se 40.000 vjeçare. Gjithashtu atje janë


Xhamia kombëtare, Abuxha

gjetur skelete njerëzore dhe disa mbetje vendbanimesh njerëzore që i përkasin periudhës parahistorike.

Gjatë periudhës midis shekullit të 6-të para erës sonë, dhe shekullit të 3-të pas Isait (a.s), në Nigerinë qendrore lulëzoi qytetërimi Nok. Statujat prej balte të lëna nga ky qytetërim, konsiderohen ndër shembujt më të vjetër të njohur të skulpturës afrikane.

Në zonën e njohur tani si Çad, gjatë shekullit të 8-të, pas Isait (a.s), u zhvillua Mbretëria Kanem. Që nga shekulli i 11-të pas Isait (a.s), kjo mbretëri u konvertua në Islam, dhe gradualisht i zgjeroi zotërimet e saj. Nga fundi i shekullit të 14-të pas Isait (a.s), shteti Bornu, i cili ndodhet në veri të Nigerisë së sotme, u bë qendra e kësaj mbretërie. Mbretëria Kanem kishte marrëdhënie tregtare me një numër vendesh të Afrikës, Azisë dhe Evropës.

Në shekullin e 11-të pas Isait (a.s), fiset Hausa krijuan disa shtete të vogla në zonën në perëndim të Bornu-së. Disa nga këto shtete, të tilla si Kano dhe Kasna, kishin marrëdhënie tregtare me vendet e Afrikës së Veriut dhe të Lindjes së Mesme. Më vonë Kano, Kebi dhe disa shtete të tjera Hausa,u bënë pjesë e Perandorisë Songai, një shtet i Afrikës Perëndimore që lulëzoi gjatë shekujve 15 dhe 16 pas Isait (a.s). Gjatë fillimit të shekullit 19-të, dijetari i shquar musliman Osman Dan Fodio, i njohur gjithashtu si Osman Ibn Fodio, i cili ishte një udhëheqës fetar Fulani, u shpalli luftë fiseve Hausa, dhe forcat e tij arritën të kontrollonin pothuajse të gjithë Nigerinë veriore, përveç Bornu-së. Kështu, ai arriti të krijonte një perandori islame, të quajtur Kalifati Skoto.

Në jug, që nga viti 1000 pas Isait (a.s), fiset Joruba krijuan një qendër të rëndësishme kulturore në rajonin Ejf. Më pas, grupet Joruba të zonës Ejf, krijuan shtete të vogla në pjesë të ndryshme të zonës aty afër, nga të cilat më e rëndësishmja ishte Mbretëria Ojo, e cila vazhdoi të ekzistonte deri në atë që tani njihet si Shteti Benin. Mbretëria Benine pati periudhën e lulëzimit të saj gjatë shekujve15 – 16 pas Isait (a.s). Kjo mbretëri u zhvillua në zonën midis Lagos dhe Deltës së Nigerit, dhe u kthye në një qendër tregtare të begatë.

Evropianët e parë që arritën në Nigeri dhe krijuan një qendër tregtare pranë Beninit, në fund të shekullit të 15-të, që ishin portugezët. Pas ardhjes së tyre atje, ata zhvilluan tregtinë e skllevërve, në partneritet me udhëheqësit e fiseve afrikane. Më vonë, britanikët, holandezët dhe tregtarët e tjerë evropianë konkurruan në këtë tregti. Nga fundi i shekullit të 18-të, britanikët u bënë tregtarët më

12

11



të shquar të skllevërve në bregdetin nigerian, por në vitin 1808, qeveria britanike vendosi ndalimin e tregtisë së skllevërve, dhe më pas bëri një sërë marrëveshjesh me vendet e tjera evropiane dhe me sundimtarët lokalë afrikanë, në një përpjekje për t'i dhënë fund kësaj tregtie. Në zbatim të kësaj, anijet britanike patrullonin bregdetin nigerian, kapnin anijet që mbanin skllevër, pastaj i lëshonin ata në portin Freetown, në Sierra Leone.

Pas vitit 1808, tregtarët britanikë filluan të tregtonin vaj palme dhe produkte të tjera bujqësore për të cilat rajoni bregdetar i Nigerisë ishte i famshëm, dhe filluan të eksploronin lumin Niger dhe rrugët e tjera ujore, në kërkim të burimeve natyrore të vlefshme. Në 1851, Britania mori portin e Lagos, për të vendosur ndikimin e saj në rajon, duke e përdorur atë si një bazë nga e cila britanikët vazhduan luftën e tyre kundër tregtisë së skllevërve. Në 1861, Lagos u bë një koloni britanike.

Në fund të shekullit të 19-të, Britania krijoi protektorate në pjesë të Nigerisë jugore, dhe një kompani tregtare britanike e quajtur Royal Niger Company (Kompania Mbretërore Nigeriane), vazhdoi të kontrollonte shumicën e pjesëve të Nigerisë veriore, deri në vitin 1900. Nigerianët në të gjitha rajonet, luftuan kundër kolonializmit britanik, veçanërisht ata në rajonet veriore, por britanikët u rezistuan atyre, dhe në vitin 1914, Britania e bashkoi Nigerinë veriore dhe atë jugore në një njësi të vetme, duke e quajtur Protektorati i Federatës së Nigerisë.

Gjatë viteve 1920, Nigerianët filluan të kërkojnë përfaqësim në qeverinë koloniale, dhe në të njëjtën kohë, rivaliteti midis grupeve të ndryshme fisnore të Nigerisë shkaktoi mosmarrëveshje midis banorëve të vendit.

Në vitin 1946, Britania e ndau Nigerinë në tri rajone: Rajoni Verior, ai Perëndimor dhe ai Lindor. Në secilën krahinë ata themeluan nga një asamble të përbërë nga anëtarë britanikë dhe nigerianë. Këto asamble përfaqësonin organet këshilluese të qeverisë qendrore në Lagos. Në vitin 1954, doli një ligj që u jepte më shumë pushtet këtyre asambleve, dhe që e bënte Nigerinë një shtet federal. Në vitin 1957, Ebu Bekr Tefaua Bliua (udhëheqësi i Veriut), u bë Kryeministri i parë i Unionit.

Më 1 Tetor të vitit 1960, Britania i dha Nigerisë pavarësinë, dhe Ebu Bekr Tefaua Bliua vazhdoi të ishte kryeministër.

SI HYRI ISLAMI NË NIGERI

Islami arriti në Afrikën Veriore përmes Shkretëtirës së Madhe, në fillimet e shekullit të parë Hixhri, me anë të tregtarëve muslimanë, edhe nëpërmjet luftërave të kryera nga tabiu i shquar Ukbe Ibn Nafi El-Fehrij, Allahu qoftë i kënaqur prej tij. Kjo gjë thuhet nga studiuesit e mëdhenj si Abdullah ibn Fodio në veprën "Tezjin El-Varakat", dhe Dr. Ali Ebu Bekr në librin e tij "Et-Thekafe El-Arabije", ku thotë: "... Pastaj ai vazhdoi marshimin e tij në jug, duke marrë qytetin Fezzan, dhe vazhdoi drejt jugut derisa arriti në pallatet Kuvar, dhe i mori ato deri në cepin më të largët, ku gjendej mbreti i atij vendi të cilin e mori edhe atë. Dhe Kuvar që përmendet këtu, nuk është larg nga kufiri verior i Nigerisë ...."

Kjo tregon qartë për hyrjen e Islamit në rajonin perëndimor të Afrikës, që nga fillimet e epokës së Islamit.

Sidoqoftë, sipas të dhënave historike, Islami depërtoi në këtë kontinent në mënyrë paqësore më shumë sesa përmes luftërave dhe pushtimit, dhe u përhap me shpejtësi të madhe.

Përgatiti:

Msc. Arta Ujkaj, *teologe*

https://en.wikipedia.org/wiki
https://ar.wikipedia.org/wiki
https://www.marefa.org
https://www.britannica.com
https://www.facebook.com/bukarabic

Shkëmbi Zuma - një monolit i madh, 725 m i lart, gjendet përgjatë rrugës kryesore nga Abuxha në Kaduna, Nigeri

ARABIA SAUDITE DO TË LEJOJË RRETH 2 MILIONË BESIMTARË TË KRYEJNË UMREN ÇDO MUAJ

Agjencia saudite e lajmeve "SPA" citoi zëvendësministrin për Haxhillëkun dhe Umren, dr. Abdulfattah bin Sulaiman Mashat, të ketë thënë se dikasteri i tij "ka punuar në koordinim me autoritetet e tjera përkatëse para fillimit të sezonit 2021-2022 të umres për të zhvilluar mekanizma ekzekutive dhe krijuar një mjedis të sigurt e të arritshëm për praktikuesit e umres gjatë udhëtimit të tyre për të garantuar sigurinë dhe shëndetin e njerëzve".

Sipas tij, një total prej 60 mijë praktikuesish të umres në ditë, të ndarë në 8 periudha operative, do të arrijnë në gati 2 milionë në muaj.

Zëvendësministri saudit për Haxhillëkun dhe Umren theksoi se aplikimet do të bëhen përmes një sistemi të integruar shërbimesh dhe masash parandaluese.

Mashat shtoi se Ministria po punon "për të përcaktuar vendet nga vijnë praktikuesit e umres dhe numrin e tyre



në baza periodike, sipas klasifikimit të masave parandaluese, si dhe kërkesat për vendet nga të cilat praktikuesit e umres dhe vizitorët e tjerë vijnë në Mbretëri".

Umreja është një pelegrinazh vullnetar në Mekë dhe myslimanët mund ta kryejnë në çdo kohë të vitit. Rituali u pezullua në shkurt 2020 për shkak të frikës nga pandemia e llojit të ri të koronavirusit (COVID-19).

Si pasojë e pandemisë, umreja lejohej vetëm për sauditët dhe rezidentët e huaj të Mbretërisë, të cilët ishin të kufizuar ta kryenin ritualin në Xhaminë e Shenjtë me 30% të kapacitetit ose jo më tepër se 6 mijë njerëz në ditë.

(www.trt.net.tr)

FRANCA MIRATON "LIGJIN E DISKUTUESHËM TË SEPARATIZMIT" QË SHËNJESTRON MYSLIMANËT

Në Francë, Këshilli Kushtetues miratoi, me përjashtim të dy neneve, ligjin e diskutueshëm të "Parimeve që përforcojnë respektimin e vlerave të Republikës", i njohur ndryshe si "ligji i separatizmit" dhe që kritikohet për vënie në shënjestër të myslimanëve.

Sipas një njoftimi për shtyp nga Këshilli Kushtetues, ligji i kaloi Këshillit nga 60 deputetë dhe 60 senatorë.

Anëtarët e Këshillit hodhën poshtë Nenin 16 në lidhje me pezullimin e aktiviteteve të shoqatave, të cilat i nënshtrohen procedurës së anulimit të ligjit, me arsyetimin se procesi mund të zgjasë 6 muaj dhe se kjo do të cenonte lirinë e shoqatave.

Këshilli nuk pranoi as Nenin 26 të ligjit për dhënien ose tërheqjen e lejes së qëndrimit një të huaji që thotë se i refuzon parimet e republikës. Kurse nenet e tjera Këshilli Kushtues i miratoi.

Franca, e cila ka popullsinë më të madhe myslimane në Evropë, kritikohet për ndërhyrjen në jetën e myslimanëve me ligjin e quajtur "Parimet që përforcojnë respektimin e vlerave të Republikës".

Ligji përfshin masa për të siguruar "neutralitetin fetar" të zyrtarëve publikë, ndërsa sistemin lidhur praktikën e mësimit në shtëpi (familje), që deri tani e shikonte të mjaftueshme një deklaratë të bërë nga familjet, e ka ndryshuar në mënyrë që për mësimin familjar këtej e tutje do të duhet të merret leje/autorizim nga autoritetet.

Ligji gjithashtu përfshin pika që dënojnë krimet e urrejtjes të kryera në internet dhe synojnë mbrojtjen e zyrtarëve publikë dhe mësuesit, dhe përfshin elementë që lidhen me luftimin e certifikatave të virgjërisë, poligamisë dhe martesave të detyruara, përveç menaxhimit "më transparent" të financave.

Sulmet ndaj xhamive dhe mesxhideve, përfshirë zjarrvëniet, janë përshkallëzuar në vend që nga shpallja e Projektligjit të Separatizmit.

(www.trt.net.tr)

Naim Drijaj,
Imam - xhamia e Parrucës

VEPRA TË MIRA QË E MBROJNË NJERIUN NGA NDËSHKIMI I XHEHENEMIT

Në sezonin e verës kuptohet më mirë se ç'do të thotë vapë dhe temperaturë e lartë. Nëse dikush i trembet temperaturës së lartë, atëherë dijeni se zjarri i xhehenemit është shumë më i nxehtë se kaq.

Pejgamberi (a.s) e përshkroi kështu xhehenemin: "Ai është zjarr, temperatura e të cilit është sa 70 fishi i temperaturës më të madhe që ju njihni në këtë botë". Kur sahabët e dëgjuan këtë thanë: "Pasha Allahun, o Profet i Zotit, edhe sikur të ishte sa nxehtësia e kësaj dynjaje, do të mjaftonte".[1]

Njerëzit duhet të kuptojnë mirë, se e ardhmja e tyre është ose xheneti i Allahut, ose zjarri i xhehenemit. Allahu është i drejtë më njerëzit dhe çdokujt do t'ia japë shpërblimin e punës që ka bërë.

Omer ibn Abdulazizi (Allahu e mëshiroftë) ka thënë: "Përgatituni për atje ku dëshironi të shkoni në ahiret!".

1. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.

Për t'u mbrojtur nga dënimi i zjarrit të xhehenemit Pejgamberi (a.s) ka përmendur udhëzime të ndryshme, duke filluar nga rregullimi i raporteve me Allahun e Madhëruar dhe duke vazhduar me rregullimin e raporteve me njëri-tjetrin.

Disa vepra të mira, që e mbrojnë njeriun nga zjarri i xhehenemit

1. Shehadeti. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Kush dëshmon, se nuk ka Zot tjetër që meriton të adhurohet me të drejtë, përveç Allahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i Allahut, Allahu ia bën haram xhehenemin".[2]

Nga Utban Ibn Malik (r.a) transmetohet se Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Allahu ia ka ndaluar zjarrin njeriut i cili thotë "La ilahe il-lallah", dhe me të synon kënaqësinë e Allahut".[3]

"Kushdo që dëshmon se nuk ka Zot tjetër, përveç Allahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i Allahut, duke e vërtetuar këtë me zemër, Allahu e ruan nga zjarri i xhehenemit...".[4]

2. Falja e namazit. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Kush i falë pesë kohët e namazit, e merr abdesin mirë dhe i falë namazet në kohën e tyre, rukunë dhe sexhden i bën ashtu siç duhet, duke besuar se këto janë e drejtë e Allahut ndaj tij, këtij njeriut Allahu ia bën haram xhehenemin".[5]

"Allahu ia ka bërë haram zjarrit të xhehenemit që të prekë ato pjesë të trupit që kanë rënë në sexhde".[6]

I Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë: "Kush i fal rregullisht katër rekate sunet para farzit të Drekës dhe katër rekate pas tij, Allahu do ta ndalojë zjarrin e xhehenemit që ta djegë atë".[7] (Pas farzit të drekës janë veç dy rekate sunet, dy rekatet e tjera është mirë të falen dhe janë prej nafileve).

3. Dashuria për Zotin. Ai njeri që e do Allahun, atë njeri Ai nuk e dënon. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Allahu nuk e dënon me zjarr të dashurin e Tij".[8]

4. Edukata dhe morali i mirë. Pejgamberi (a.s) u ka thënë shokëve të tij: "I është ndaluar zjarrit të xhehenemit ta djegë atë që është i lehtë (për tu marrë vesh me të), i butë, i dashur dhe i afërt me njerëzit".[9]

5. Puna që bën në rrugën e Zotit. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Allahu nuk i dënon me zjarr ato këmbë, që janë pluhurosur në rrugën e Tij".[10]

6. Të qash nga frika e Zotit. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Dy sy nuk

2. Transmetuar nga Muslimi.
3. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.
4. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.
5. Transmetuar nga Imam Ahmedi.
6. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.
7. Transmetuar nga Ebu Daudi dhe Tirmidhiu.
8. Transmetuar nga Imam Ahmedi.
9. Transmetuar nga Tirmidhiu dhe Imam Ahmedi.
10. Transmetuar nga Buhariu.

> Shtatë kategori njerëzish do të hyjnë nën hijen e Arshit të Allahut, atë Ditë kur s'ka hije tjetër përveç hijes së Tij; njëri prej atyre është edhe ai që e përmend Allahun në vetmi dhe i mbushen sytë me lot!

i djeg zjarri i xhehenemit; atë sy i cili loton nga frika e Allahut dhe atë sy, i cili e kalon natën duke ruajtur në rrugën e Allahut.[11]

"Shtatë kategori njerëzish do të hyjnë nën hijen e Arshit të Allahut, atë Ditë kur s'ka hije tjetër përveç hijes së Tij; njëri prej atyre është edhe ai që e përmend Allahun në vetmi dhe i mbushen sytë me lot".[12]

"Tre grupe të njerëzve nuk do t'i prekë zjarri i xhehenemit; ai i cili ruan në rrugë të Allahut, ai i cili qan nga frika e Allahut dhe ai, i cili e ruan shikimin e tij nga gjynahet".[13]

Allahu (xh.sh) thotë: "Thuaju, o i Dërguar, besimtarëve që të ulin shikimin e tyre...".[14]

7. Përmendja e shehadetit para daljes së shpirtit. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Kur njeriu thotë: Nuk ka të adhuruar tjetër, përveç Allahut, Allahu është më i Madhi, atëherë Allahu i Lartësuar thotë: "Të vërtetën ke thënë o robi im" nuk ka të adhuruar tjetër, përveç Meje; Unë jam më i Madhi!

Kur njeriu thotë: Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut, i Vetëm, i Pashoq është Ai, atëherë Allahu i Madhëruar thotë: Nuk ka të adhuruar tjetër, përveç Meje, i Vetëm dhe i Pashoq jam!

Kur njeriu thotë: Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut, i Vetëm dhe i Pashoq është Ai, Atij i përket sundimi dhe falënderimi, atëherë Allahu (xh.sh) thotë: Nuk ka të adhuruar tjetër, përveç Meje, Mua më përket sundimi dhe falënderimi!

Kur njeriu thotë: Nuk ka të adhuruar tjetër, përveç Allahut dhe nuk ka ndryshim dhe forcë veçse me ndihmën e Allahut, atëherë Allahu i Madhëruar thotë: Nuk ka të adhuruar tjetër, përveç Meje dhe nuk ka ndryshim e as forcë pa lejen Time!

Pastaj Pejgamberi (a.s) tha: Kujt i mundësohet që t'i thotë këto fjalë në momentet e vdekjes, këtë njeri nuk e prekë zjarri i xhehenemit."[15]

T'i përkujtohet shehadeti personit që është në momentet e fundit të jetës.

Transmetohet nga Ebu Se'id El-Khudrij (r.a) se i Dërguari i Allahut ka thënë: "Përkujtojani atyre që janë në pragtëvdekjesfjalën"Lailaheil-lallah!".[16]

11. Transmetuar nga Tirmidhiu.
12. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.
13. Transmetuar nga Taberaniu.
14. Kur'ani, En-Nur: 30.
15. Transmetuar nga Ibn Maxheh.
16. Transmetuar nga Muslimi.

Transmetohet nga Mu'adh ibn Xhebeli (r.a) se i Dërguari i Allahut ka thënë: "Ai, që fjala e fundit e tij është "La ilahe il-lallah", do të hyjë në Xhennet".[17]

8. Vdekja e fëmijëve. Transmetohet nga Ebu Hurejre (r.a) se një grua erdhi te i Dërguari i Allahut me një fëmijë në dorë dhe i tha: "O i Dërguar i Allahut, lute Allahun për të, sepse i kam varrosur tre fëmijë. Profeti (a.s) i tha: "Ti qenke mbrojtur me një mburojë të fortë nga zjarri i xhehenemit".[18]

Transmetohet nga Xhabir ibn Abdullahi (r.a) se ka dëgjuar Profetin (a.s) duke thënë: "Kujt i vdesin tre fëmijë dhe ai bën durim duke shpresuar shpërblimin nga Allahu, ai do të hyjë në xhenet". Atë e pyetën: Po atij që i vdesin dy fëmijë, o i Dërguar i Allahut? "Edhe atij që i vdesin dy fëmijë?"

Një nga transmetuesit thotë: Mendoj se nëse do ta pyesnit edhe për atë që i vdes një fëmijë, do të thoshte edhe për një fëmijë. Xhabiri tha: Pasha Allahun edhe unë kështu mendoj.[19]

Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Kur një njeriut i vdes fëmija, Allahu u thotë melekëve të Tij: A ja morët shpirtin fëmijës së robit Tim? Ata thonë: Po! Ai thotë: A ia morët frytin e zemrës së tij? Ata thonë: Po! Ai thotë: Po robi Im, çfarë tha? Ata thonë: Të falënderoi Ty (dhe tha: Të Allahut jemi e tek Ai do të kthehemi). Allahu thotë: Ndërtojini robit Tim një shtëpi në xhenet dhe quajeni: "Shtëpia e falënderimit".[20]

9. Duaja (lutja). Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Kushdo që i kërkon Zotit xhenetin tre herë me fjalët: "O Zot, më dhuro xhenetin", xheneti i thotë Zotit: "O Zot, fute atë person tek unë". Dhe ai i cili i lutet Allahut që ta mbrojë nga zjarri i xhehenemit tre herë me fjalët: "O Zot, më ruaj nga zjarri i xhehenemit", xhehenemi thotë: "O Zot, ruaje atë person nga unë".[21]

Enesi (r.a) ka thënë: Duaja që Pejgamberi (a.s) më së shumti e thoshte, ishte: "Zoti ynë na jep të mira në këtë dynja dhe në ahiret dhe na ruaj prej dënimit të zjarrit!".[22]

17. Transmetuar nga Ebu Daudi.
18. Transmetuar nga Muslimi.
19. Transmetuar nga Imam Ahmedi dhe Bejhakiu.
20. Transmetuar nga Tirmidhiu.
21. Transmetuar nga Tirmidhiu dhe Imam Ahmedi.
22. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi. Ndërsa ajeti gjendet në suren El-Bekare: 201.



I Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë:

"GJASHTË GJËRA, TË CILAT SIGUROJNË XHENETIN

UBADE IBN SAMIT (R.A) TRANSMETON SE PEJGAMBERI (A.S) KA THËNË:

"MË SIGURONI GJASHTË GJËRA, UNË JU SIGUROJ XHENETIN:

1. FLISNI TË DREJTËN,
2. MBANI PREMTIMET,
3. KRYENI AMANETET,
4. RUANI NDERIN,
5. ULNI SHIKIMET,
6. NDALNI DUART."

(Transmetuar nga Imam Ahmedi, Ibn Hibbani dhe Hakimi)

DR. MURHAF SAKKA: "MODELI I PROFETËVE, SHEMBULL FRYMËZUES I BASHKIMIT NË MESIN E NJERËZVE!"

- Seminar trajnues me imamët e Shkodrës -

Pasditën e të hënës, më 2 gusht 2021, në sallën e re të ligjëratave, Myftinia Shkodër organizoi seminarin e radhës me një grup të imamëve dhe thirrësve islamë të zonës Shkodër, me tematikë: "Detyrat e thirrësit në misionin e tij".

Fillimisht, përshëndetën Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari dhe Myftiu i Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj, të cilët i uruan pjesëmarrjen në këtë seminar, mysafirit të nderuar, pedagogut të shkencave të Kuranit, Dr. Murhaf Sakka nga Siria, i cili prej disa ditëve po viziton qytetin tonë, me ftesë të Myftinisë Shkodër.

Dr. Sakka gjatë ligjëratës së tij, pasi çmoi lart qytetin e Shkodrës për mikpritjen, bujarinë, për vlerat e besimit dhe harmonisë në mes njëritjetrit, dha disa këshilla dhe mesazhe të çmueshme për imamët, të cilët sipas tij gjatë thirrjes islame duhet të kenë parasysh disa detyra; të jenë shembull besimi, adhurimi dhe morali në shoqëri, model i profetëve, shembuj frymëzues të bashkimit në mes njerëzve, ruajtës të traditave dhe zakoneve të mira që janë vlerë e shtuar e besimit si dhe të thërrasin njerëzit në besim të vërtetë e të drejtë në mënyrën më të mirë dhe të urtë.

Në fund të këtij takimi, Myftiu i Shkodrës i dhuroi mysafirit nga Shami Sherif, shallin me flamurin tonë kombëtar, si kujtim i kësaj vizite të shtrenjtë në Shkodër.

MYFTIU PRITI IMAMIN E XHAMISË SHQIPTARE NË TORONTO

Paraditën e së mërkurës, më 4 gusht 2021, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt, imamin e xhamisë shqiptare në Toronto të Kanadasë, të nderuarin Adnan ef. Berbatovci.

Gjatë takimit dy bashkëbiseduesit ndanë eksperiencat dhe vizionet e tyre në drejtim të bashkëpunimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të Thirrjes Islame, sidomos në trojet tona dhe tek shqiptarët, kudo qofshin.

Myftiu e njohu mikun e mirë me historinë e aktivitetit islam në Shkodër, sidomos gjatë shekullit të shkuar, deri në ditët tona, sikurse e prezantoi edhe me aktivitetin botues të Myftinisë Shkodër, me ç'rast i dhuroi atij edhe disa botime personale dhe disa nga titujt e botuar nga Myftinia Shkodër.

Me rastin e kësaj vizite, Myftiu Sytari i dorëzoi imamit të xhamisë shqiptare në Toronto, një Certifikatë Mirënjohjeje për kontributin e vëllezërve tanë në Toronto për gjallërimin e atmosferës së Kurban Bajramit të sivjetshëm në Shkodër.

PËRCILLET ME NDERIME PËR NË BANESËN E FUNDIT PROF. AHMET OSJA

Paraditen e të martës, më 3 gusht 2021, besimtarë të shumtë, qytetarë shkodranë, intelektualë të qytetit dhe drejtues të Medresesë dhe të Myftinisë Shkodër, morën pjesë në ceremoninë e xhenazes para përcjelljes së prof. Ahmet Osman Osja, i cili ndërroi jetë ditën e hënë, më 2 gusht 2021 në moshën 78-të vjeçare.

Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, gjatë fjalës së tij vlerësoi lart figurën dhe kontributin e çmuar të Ahmet Osjes, në aspekt të dijes, urtësisë, thjeshtësisë dhe mençurisë, si mësues, edukator, koleg dhe intelektual që punoi dhe dha kontributet e tij për dijen, qytetarinë dhe në mënyrë të veçantë për Medresenë "Haxhi Sheh Shamia".

Myftiu nënvizoi se i nderuari Ahmet Osja, si një ndër themeluesit kryesorë të Medresesë së Shkodrës dhe drejtor i parë i saj, do të mbetet në memorien e gjithsecilit dhe do të kujtohet vazhdimisht në mexhlise, në biseda dhe takime për tiparet e një njeriu të mirë, plotë vlera dhe shembuj konkret që ka dhënë në shërbim të besimit, arsimit, vendit në përgjithësi etj.

Më pas, dy fjalë të fundit dha edhe drejtori aktual i medresesë së Shkodrës, z. Kujtim Dervishi, i cili në mes të tjerave tha se ka pasur fatin e mirë të bashkëpunojë me të nderuarin prof. Ahmet Osja, që sipas tij, do të mbetet përherë në kujtim të gjithë brezave të medresesë për rolin e tij të madh në themelimin e kësaj vatre të madhe të dijes dhe kulturës në vitet më të vështira të rimëkëmbjes pas vitit 1990.

Në fund u fal xhenazeja e drejtuar nga Myftiu i Shkodrës si dhe u bënë lutje për shpirtin e tij që Allahu ta mëshirojë dhe ta bëjë nga banorët e xhenetit.

NË MËSHIRËN E ALLAHUT, HAFIZ SHUKRI KAPLLANI

Ditën e martë, më 31 gusht 2021, në orët e para të mëngjesit ndërroi jetë në moshën 66 vjeçare, Hafiz Shukri Kapllani, imami dhe veprimtar i zellshëm i Myftinisë Shkodër.

Hafiz Shukri Kapllani, u lind në Bafra, Samsun të Turqisë, më 1 maj 1955.

Ai ka kryer shkollën e lartë të hifzit të Kuranit, pranë Diyanet Isleri Baskanligi në Turqi.

Me rihapjen e fesë në vendin tonë, në vitin 1992 ai emërohët nga shoqata "Vakfi Islam Turk Sulejmanije", si drejtues i medresesë së Bushatit, detyrë të cilën e ka ushtruar deri në momentin e fundit të jetës së tij.

Për 29 vite, i caktuar nga Myftinia Shkodër ka shërbyer si imam në xhaminë e Bushatit dhe si një udhëzues shpirtëror për të gjithë imamët dhe besimtarët e zonës së Nën-Shkodrës.

Hafiz Shukri Kapllani është i njohur edhe për kontributin e tij të madh në mësimdhënien e lëndës së Kuranit në medresenë e Bushatit, për zërin e tij melodioz në këndimin ilahive dhe pjesëve të Mevludit Sherifit.

H. Shukri Kapllani gjatë ushtrimit të misionit të tij në Shqipëri, kryesisht në Shkodër është vlerësuar me Certefikata Mirënjohjeje nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Myftinia Shkodër.

Komuna Bushat e ka vlerësuar si: "Qytetar Nderi" për kontributet e dhëna në edukim, përhapjen e thirrjes islame, në forcimin e tolerancës, harmionisë dhe mirëkuptimit në komuntetin e zonës ku ka shërbyer për vite të tëra.

Myftinia Shkodër i shpreh familjes së rahmetliut Hafiz Shukri Kapllani, ngushëllimet më të ngrohta dhe të përzemërta dhe i lutet Allahut të Madhëruar ta bëjë prej banorëve të xhenetit!

PËRCILLET ME NDERIME "MJESHTRI I MADH" KUJTIM ALIJA

Ditën e xhuma, më 27 gusht 2021 ka ndërruar jetë, "Mjeshtri i Madh", Kujtim Alia.

"Mjeshtri i Madh", Kujtim Alija, simbol i dashurisë për artin e muzikës dhe festivalet të fëmijëve, ndërroi jetë në moshën 60-vjeçare pas një sëmundjeje të rëndë.

Pas rilejimit të besimit fetar në Shqipëri, z. Kujtim Alija, përveç profesionit të tij si muzikant, ka punuar edhe si mësues i lëndës së muzikës pranë Medresesë së Shkodrës, si dhe ka organizuar dhe drejtuar grupet rinore të këndimit të ilahive, duke filluar tek xhamia e Plumbit, salla e faljes në Parrucë, tek xhamia e vjetër e Kirasit, etj.

Gjithashtu, mjeshtri Kujtim Alija është i njohur edhe për kontributin e tij të madh në drejtimin e koncerteve të larmishme me ilahi dhe recitime, të organizuara nga Myftinia Shkodër në vitet e parë të demokracisë, me rastin e Bajrameve, Mevludeve dhe datave të tjera të rëndësishme islame.

Myftinia Shkodër i shpreh familjes së të ndjerit Kujtim Alija, ngushëllimet më të ngrohta dhe të përzemërta dhe i lutet Allahut të Madhëruar ta bëjë prej banorëve të xhenetit.

INSPEKTOHEN XHAMITË E LAGJEVE TEPE DHE DRAÇIN

Ditën e enjte, më 5 gusht 2021, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i shoqëruar edhe nga administratori i Myftinisë Shkodër, z. Sajmir Dritareti, inspektoi nga afër xhamitë e lagjeve Tepe dhe Draçin, në afërsi të cilave, u ndezën vatra zjarri, që me mirësinë e butësinë e Zotit, u shuan pa dëme të mëdha, edhe falë ndërhyrjes së repartit të zjarrfikësve të qytetit.

Gjatë këtij inspektimi u pa edhe gjendja aktuale e dy xhamive, u diskutua frekuentimi i tyre, mirëmbajtja dhe u dhanë disa udhëzime për përmirësimin e gjendjes së xhamive, në shërbim të besimtarëve dhe kalimtarëve të ndryshëm.

Xhamia e Tepes

LIGJËRATA DHE MESAZHE TË DOBISHME NGA DR. MURHAF SEKKA

Me ftesë të Myftinisë Shkodër, për disa ditë qëndroi për vizitë në qytetin tonë, studiuesi islam sirian, Dr. Murhaf Sekka, i specializuar në shkencat e Kuranit, pedagog universitar dhe autor i disa veprave vëllimore rreth mrekullive shkencore në Kuranin Famëlartë.

Gjatë vizitës së tij në Shkodër, i nderuari Dr. Sekka, ligjëroi në xhaminë "Ebu Bekër" dhe në xhaminë e Parrucës, sikurse zhvilloi një seminar me vlerë me imamë e teologë të Myftinisë së Zonës Shkodër.

Në mesazhet e ligjëratave të tij, Dr. Murhaf Sekka u përqendrua tek pozita e dijes në Islam, tek domosdoshmëria e shfrytëzimit të kohës për të zhvilluar personalitetin e muslimanit ndërtues, sikurse vuri theksin tek rëndësia e pajisjes me moral të bukur, që mbi të gjitha duhet të jetë mënyra më e mirë e identifikimit të muslimanit në jetë.

Studiuesi islam nga Siria, vizitoi edhe Myftininë Shkodër, ku u prit nga Myftiu i saj, Imam Muhamed B. Sytari, sikurse zhvilloi disa vizita në xhami të ndryshme të Shkodrës, ku në veçanti shfaqi emocionet dhe kënaqësinë e faljes në xhaminë e Plumbit, në xhaminë e Tophanës, në xhaminë e Parrucës, në xhaminë e "Dy Vajzave", në xhaminë "Ebu Bekër", etj.

Ndërkohë, të xhumanë, më 6 gusht 2021, në ligjëratën e mbajtur në xhaminë "Ebu Bekër", në Fushë-Çelë, zotëria e tij hodhi dritë mbi vlerën e madhe që ka salavati, si një adhurim që na mban të lidhur me pejgamberin tonë dhe mesazhet jetike që na sjell fjala dhe shembulli i tij, paqja e Allahut qoftë mbi të!

ME ZEMËR TË MIRË
VITIN E RI HIXHRI

سنة هجرية سعيدة

1 muharrem 1443
9 gusht 2021

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org

Çmimi: 50 lek